



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE

Tiranë, më 26.3.2025

Njoftim për pozicion të lirë pune

Në zbatim të ligjit nr. 53/2019 “*Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, të *Statutit* të saj, i ndryshuar, të vendimit nr. 35/2020 datë 09.07.2020 të Kuvendit të Shqipërisë “*Për strukturën dhe organikën në Akademinë e Shkencave*”, i ndryshuar dhe të Rregullores së brendshme administrative të Akademisë së Shkencave, neni 101, shpallet vendi i lirë:

- Pozicionin *punonjës pastrimi, klasa II*.

Pozicioni i punës është pranë *Sektorit ndihmës* në administratën e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

- **Kriteret e përgjithshme dhe specifike:**

Kritere të përgjithshme:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën e njësuar shqipe, me shkrim e të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore të mira, që lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të plotësojë kriteret specifike të vendosura në bazë të përshkrimit të vendit të punës për formimin, kualifikimin, përvojën etj.;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale që përbën pengesë ligjore;
- Të mos ketë masë disiplinore për largim nga detyra apo që nuk është parashkruar;
- Të mos ketë masë ndëshkimore në fuqi, nga komisionet e etikës.
- Të jetë a të vendoset me banim në Tiranë.

- **Kritere specifike:**

- Të ketë përvojë pune në institucionet publike.

- Dokumentet dhe afati i dorëzimit

Dokumentet që duhet të paraqesë kandidati:

Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi në një zarf të mbyllur pranë zyrës së protokollit dokumentet e dosjes së tij personale, që i drejtohen kancelarit dhe/ose njësisë përgjegjëse brenda 10 (dhjetë) ditësh nga shpallja e vendit të lirë, si më poshtë:

1. *Kërkesën me shkrim;*
2. *Curriculum Vitae;*
3. *Diplomë, letërnjoftim dhe librezë pune (origjinale ose të noterizuar).*
4. *Vërtetimin e zotërimit të gjuhës së huaj;*
5. *Dëshmi penaliteti.*
6. *Vërtetimi i gjendjes shëndetësore (original).*
7. *Vlerësim pune nga punëdhënësi i fundit (nëse ka)*

Afati i dorëzimit të dokumenteve:

Pranimi i dokumenteve bëhet deri me datën 4.4.2025 ora 12:00. Gjatë kësaj periudhe kandidatët kanë të drejtën të konsultohen me njësinë përgjegjëse të personelit për plotësimin e dokumentacionit. Pas këtij afati nuk pranohet asnjë aplikim për këtë vend pune.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë

www.akad.gov.al

Përshkrimi i punës:

Punonjësi i pastrimit

Punonjësi i pastrimit kryen këto detyra:

- a) paraqitet në punë 90 minuta para fillimit të orarit zyrtar të punës;
- b) përgjigjet për pastrimin e të gjitha mjediseve të Akademisë;
- c) kujdeset për rregullin dhe pastërtinë e sallave të ASH-së përpara, gjatë dhe pas aktiviteteve;
- ç) zbaton normat për konsumin e detergjentëve dhe mban në gjendje pune pajisjet e pastrimit;
- d) kryen me përgjegjësi çdo detyrë tjetër që i ngarkohet.